

# KRIMI I ORGANIZUAR NË ZGJEDHJE

## ANALIZË E POLITIKËS SË NDJEKJES DHE DËNIMEVE

Betim Musliu • Adem Gashi



Qershor, 2012  
Prishtinë

Përkrahur nga:

**FRIEDRICH  
EBERT**  
  
**STIFTUNG**

Prishtina Office

KRIMI I ORGANIZUAR NË ZGJEDHJE  
ANALIZË E POLITIKËS SË NDJEKJES DHE DËNIMEVE

Ky raport është përkrahur nga: Friedrich Ebert Stiftung



Ky raport nuk paraqet qëndrimet e Friedrich Ebert Stiftung

Autorët: Betim Musliu dhe Adem Gashi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Qershor 2012

Prishtinë, Republika e Kosovës

## **PËRMBAJTJA**

|                                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Përmbledhje Ekzekutive.....                                      | 5  |
| 2. Hyrje.....                                                       | 7  |
| 1.1. Metodologjia.....                                              | 8  |
| 3. Korniza ligjore .....                                            | 10 |
| 4. Politika e Ndjekjes.....                                         | 12 |
| 1.2. Manipulimi i votave të kandidatëve .....                       | 13 |
| 1.3. Krimi i organizuar .....                                       | 16 |
| 1.3.1. Grup i strukturuar .....                                     | 18 |
| 1.3.2. Dënueshmëria më e lartë se katër vjet.....                   | 19 |
| 1.3.3. Dobia tjetër pasurore .....                                  | 19 |
| 1.3.4. Dobitë nga hyrja në politikë.....                            | 22 |
| 1.4. Çështjet tjera që kontribuan në manipulimin e zgjedhjeve ..... | 25 |
| 5. Politika e Dënimeve.....                                         | 29 |
| 6. Kosto për Shërbimin Korrektues të Kosovës .....                  | 33 |
| 7. Përfundimet.....                                                 | 34 |
| 8. Rekomandimet .....                                               | 35 |

## SHKURTESAT

|       |                                                            |
|-------|------------------------------------------------------------|
| AAK   | Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës                           |
| AKK   | Agjencia Kundër Korrupsionit                               |
| FRK   | Formularët e Rezultateve të Kandidatëve                    |
| IKD   | Instituti i Kosovës për Drejtësi                           |
| KQZ   | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve                             |
| LDK   | Lidhja Demokratike e Kosovës                               |
| MPB   | Ministria e Punëve të Brendshme                            |
| OKB   | Organizata e Kombeve të Bashkuara                          |
| PDK   | Partia Demokratike e Kosovës                               |
| PK    | Policia e Kosovës                                          |
| PSRK  | Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës                |
| PZAP  | Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa                 |
| QNR   | Qendra e Numërimit dhe Rezultateve                         |
| UNMIK | Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| VV    | Lëvizja Vetëvendosje                                       |

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zgjedhjet janë faktor i rëndësishëm i stabilizimit dhe demokratizimit në demokracitë në zhvillim dhe shtetet post-konfliktuale.<sup>1</sup> Republika e Kosovës vazhdon të ketë probleme esenciale me organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve në vend. Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 u karakterizuan me manipulime të shumta, ku u organizua rivotim i plotë dhe i pjesshëm në gjashtë (6) komuna dhe u rinumëruan 890 vendvotime. Dëmet e manipulimeve përfshijnë por nuk kufizohen në humbje të besimit të qytetarëve në procesin e zgjedhjeve, vënien në pikëpyetje të legjitimitetit të Kuvendit, dëmtimin e institucioneve dhe buxhetit, dhe dëmtimin e imazhit të vendit.

Korniza ligjore mundëson ndjekjen dhe gjykimin efikas të të gjitha llojeve të manipulimit të zgjedhjeve. Në dhjetor 2010, Gjykata Supreme dhe Prokurori i Shtetit për herë të parë kishin shpallur ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të zgjedhjeve si lëndë me prioritet.<sup>2</sup> Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve kanë ofruar informata për 854 raste të cilat ndërlidhen me zgjedhjet, ku përfshihen mbi 5,000 persona. Prokurorët kanë ngritur akuza për 221 raste ndaj 1,516 personave dhe se në proces të ngritjes së aktakuzave janë edhe 758 komisionerë të tjerë.<sup>3</sup> Megjithatë, gjykatësit janë treguar jo efikas duke konfirmuar vetëm 94 raste.

Prokurorët duke nxituar në nxjerrjen e shifrave kanë zbatuar një politikë jo adekuate të ndjekjes, duke dështuar që të shqyrtojnë mundësinë e krimit të organizuar. Manipulimi i zgjedhjeve ishte organizuar në mënyrë sistematike, ku kishte elemente të krimit të rëndë, grupeve të strukturuar dhe të përfitimit të dobisë tjetër pasurore. Auditimi i 890 vendvotimeve nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve ka nxjerrë në pah se parregullsi të cilat kanë kaluar marzhën e gabimeve të lejueshme ka pasur në mbi 712 vendvotime, ku përfshihen rreth 5,000 komisionerë. Edhe pse këta persona në vende të ndryshme, në kohë të njëjtë kanë vepruar njëjtë, Prokurori i Shtetit dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës nuk hetojnë asnjë person për organizimin e manipulimeve. Përkundër akuzave publike të zyrtarëve të lartë politik për njëri-tjetrin rreth urdhrave për manipulim të votave në mënyrë të organizuar, deri më tani asnjë zyrtarë i këtij niveli nuk është i ndjekur apo gjykuar. Tutje, dështimi i prokurorëve për të hetuar financimin e dyshimtë të partive politike, dështimin e materialeve zgjedhore dhe të listat e pasakta të votuesve mund të jetë

---

<sup>1</sup> Winrich Kuhne, *Roli i Zgjedhjeve në Demokracitë në Zhvillim dhe shtetet post-konfliktuale* (Friedrich Ebert Stiftung, gusht 2010), f. 1.

<sup>2</sup> IKD intervistë me z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, dhe z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, prill-maj 2012.

<sup>3</sup> IKD intervistë me znj. Laura Pula, Prokurore në Prokurori të Shtetit dhe Koordinatore e lëndëve të zgjedhjeve, maj 2012.

sinjal i keq pasi që persona të cilët janë përfshirë në veprime kriminale që ndërlidhen me procesin e zgjedhjeve do të mbesin pa u ndëshkuar.

Gjykatat Komunale deri më tani kanë pranuar në punë 154 lëndë,<sup>4</sup> nga të cilat kanë zgjidhur vetëm 41 sosh ku përfshihen 191 persona. Ndaj 69% të personave dënimet kanë qenë me gjobë dhe kusht, ndërsa vetëm 9.4% e tyre janë dënime me burgim efektiv. Dënimet e shqiptuara në këto raste janë jo meritore duke pasur parasysh dëmet e shkaktuara. Dënimet e Gjykatave Komunale kanë filluar t'i korrigjojnë Gjykatat e Qarkut, duke ndjekur një politikë më të ashpër të dënimeve, përkatësisht dënime me burgim efektiv prej gjashtë muajve për secilin të akuzuar.<sup>5</sup>

Manipulimet e zgjedhjeve kanë pasur implikime buxhetore ku Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka qenë palë e dëmtuar.<sup>6</sup> Përkundër udhëzimeve të gjykatave që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të ushtroj padi civile për kompensim, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur.

Kjo është hera e parë që organet e drejtësisë janë duke bërë reagim më adekuat për ndjekje dhe gjykim të manipulimit të zgjedhjeve në Kosovë. Megjithëse qasja e deritanishme mund të kontribuoj në një masë për parandalimin e këtyre krimeve në të ardhmen, assesi nuk mund të jetë e suksesshme për të vendosur drejtësi dhe parandalim të mirëfilltë përderisa nuk kemi persona të ndjekur dhe dënuar për organizimin e manipulimeve.

---

<sup>4</sup> Vëni re se ka mospërputhje të statistikave ku sipas statistikave të Prokurorit të Shtetit, gjykatat kanë konfirmuar 94 akuza, ndërsa sipas Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjykatat kanë në punë 154 lëndë kjo pasi që gjykatat numërojnë po ashtu edhe lëndët e zgjedhjeve që kanë qenë nga viti 2007 dhe 2009.

<sup>5</sup> IKD ka siguruar aktgjykimet e Gjykatave të Qarkut përmes Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, maj 2012.

<sup>6</sup> *Aktgjykim ndaj tetë të akuzuarve për veprën penale mashtrim në votime, neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Aktgjykimi numër P.nr.163/2011*, Gjykata Komunale në Glogoc, 27 maj 2011. Po ashtu, *aktgjykim ndaj gjashtë të akuzuarve për veprën penale mashtrim në votime, neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Aktgjykimi numër AP.nr.41/2012*, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, 7 maj 2012.

## 2. HYRJE

Zgjedhjet e vitit 2010 në Republikën e Kosovës, të parat zgjedhje të përgjithshme të organizuara pas shpalljes së pavarësisë, sjellin kujtime të hidhura të manipulimit industrial të votave. Si pasojë e këtij manipulimi, u organizua procesi i rivotimit në katër komuna (Skënderaj, Drenas, Deçan, dhe Mitrovicë) dhe dy vendvotime në dy komuna tjera (Lipjan dhe Malishevë),<sup>7</sup> si dhe është bërë rinumërimi i 890 vendvotimeve.<sup>8</sup> Manipulimi i zgjedhjeve tregoi edhe një herë për mungesën e vullnetit të parisë së Kosovës për të konsoliduar mekanizma demokratik, duke pasur parasysh se zgjedhjet janë themel i një shoqërie demokratike. Manipulimi i organizuar i zgjedhjeve kishte ndodhur gjithandej Kosovës, dhe si i tillë nuk mund të paramendohet pa miratimin e zyrtarëve të lartë të partive politike. Elementet e këtyre krimeve bëjnë që të përjashtohet mundësia se këto akte kanë qenë të izoluar në lokacione të caktuara.

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare,<sup>9</sup> administrata e politizuar,<sup>10</sup> dhe mundësitë tjera të përfitimit bëjnë që partitë politike të konsiderojnë pushtetin si mjetin kyç për të siguruar përfitime materiale dhe jo-materiale për anëtarët dhe mbështetësit e tyre. Andaj, ekziston një motiv i fortë që të fitojnë zgjedhjet me çdo kusht, duke mos kursyer asnjë mjet. Para zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, organet e drejtësisë kishin një përgjigje të vobektë apo pothuajse inekzistente ndaj krimeve që ndërlidhen me manipulimin e zgjedhjeve.<sup>11</sup> Prokurorët dhe gjykatësit duke anashkaluar faktin se një sërë krime tjera në vend rrjedhin si pasojë e krimeve të zgjedhjeve, ndër vite kanë zbatuar një politikë të gabuar të (mos)veprimit të tyre. Rrjedhimisht, ata vetëm sa kanë stimuluar vjedhjen e votave. Me të drejtë pas përfundimit të procesit të votimit në dhjetor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës dhe Prokurori i Shtetit kishin shpallur prioritet lëndët të cilat ndërlidhen me zgjedhjet,<sup>12</sup> duke shënuar për herë të parë ndryshimin e qasjes dhe aktivizimin e tyre për t'u përballur me këto krime.

---

<sup>7</sup> Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përsëritjen e votimit të Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës në Komunitet Drenas, Skenderaj dhe Deçan si dhe përsëritjen e votimit në disa Qendra Votimi në Komunitet Lipjan dhe Malishevë, vendimi i protokolluar me numër 1621-2010, i marrë me 16 dhjetor 2010. Po ashtu, Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përsëritjen e votimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 12 dhjetorit 2010 në Komunitet Mitrovicë, vendimi i protokolluar me numër 38-2011, i marrë me 10 janar 2011.

<sup>8</sup> IKD komunikim përmes postës elektronike me z. Burim Ahmetaj, Koordinator i Qendrës për Numërim dhe Rezultate, maj 2012.

<sup>9</sup> *Raporti i Progresit 2011 për Kosovën* (Bruksel: Komisioni Evropian, 12 tetor 2011), f. 14.

<sup>10</sup> Ligjëratë e Ministres së Integrimeve Evropiane znj. Vlora Çitaku. Jeton Llapashtica, "Çitaku: Politika po e "dhunon" administratën". *Zëri Info*, 19 maj 2012. Shih <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/49604/citaku-politika-po-e-dhunon-administraten> (qasur për herë të fundit më 23 maj 2012).

<sup>11</sup> *Raporti mujor-maj 2009* (Prishtinë: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë OSCE - Departamenti për të Drejtat të Njeriut dhe Komunitete-Spektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor).

<sup>12</sup> IKD intervistë me z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, dhe z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, prill-maj 2012.



Lëndët e manipulimit të zgjedhjeve të përgjithshme të dhjetorit 2010 dhe rivotimit të janarit 2011 erdhën menjëherë pas disa proceseve mjaftë të rëndësishme nëpër të cilat kishte kaluar sistemi i drejtësisë në Kosovë, sikurse që ishte procesi i ri-emërimit dhe emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve dhe rritja e të ardhurave të tyre. Ky ishte një rast i mirë për sistemin e drejtësisë që të vërtetoj se reforma ishte thelbësore dhe jo vetëm sipërfaqësore.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (në vazhdim, IKD) ka vendosur të zhvilloj një raport hulumtues, përshkrues dhe analitik rreth përgjigjes së organeve të drejtësisë ndaj krimeve të zgjedhjeve, me fokus të veçantë në ndjekjen dhe gjykimin e personave të cilët kanë organizuar, mbështetur, shtyrë dhe financuar këto krime. Tutje, IKD ka ofruar rekomandime konkrete të cilat do të shërbenin që organet e drejtësisë të përfitojnë njohuri të reja rreth këtyre krimeve dhe në të ardhmen të zbrapsim të gjithë personat që synojnë të përfshihen në këto krime. IKD ndjen obligim që të monitoroj se krimet e zgjedhjeve janë duke u ndjekur dhe gjykuar në mënyrë meritore ashtu që të përmbushen dy qëllime kryesore: **vendosja e drejtësisë dhe parandalimi i krimit në të ardhmen.**

### **1.1. Metodologjia**

IKD me qëllim që të zhvilloj një raport gjithëpërfshirës të përgjigjes së organeve të drejtësisë ndaj krimeve të zgjedhjeve, ka kombinuar forma dhe elemente të ndryshme të hulumtimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në të dhëna statistikore, intervista gjysmë të strukturuar, analizë të legjislacionit dhe praktikave vendore dhe ndërkombëtare, dhe analizë të rasteve të veçanta të ndjekjes dhe gjykimit që ndërlidhen me zgjedhjet.

Fillimisht, IKD ka analizuar kornizën ligjore e cila rregullon fushën e ndjekjes dhe gjykimit të parregullsive që ndodhin në proceset zgjedhore. IKD i ka kushtuar rëndësi të veçantë mangësive dhe dispozitave të Kodit Penal, si dhe ka konsultuar komentare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara rreth dispozitave të caktuara sikurse që është “dobia tjetër pasurore a financiare”. Pas përfundimit të kësaj analize, IKD ka siguruar të dhëna statistikore dhe raste të ndjekjes dhe dënimeve të personave të përfshirë në manipulimet e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010. E gjithë kjo ka shërbyer për të përgatitur materialin për intervista të thelluara me hisedarët kyç në këto procese. IKD ka zhvilluar gjithsej 35 intervista me prokurorë (Prokurori i Shtetit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Prokurori Komunale, dhe Prokurori të Qarkut), gjykatës (Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata të Qarkut, dhe Gjykata Komunale), përfaqësues të partive politike, deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ekspert juridikë, akademikë të së drejtës penale dhe civile, zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, si dhe aktivistë të shoqërisë civile. Të gjitha këto kanë shërbyer për përpilimin e raportit përfundimtar. IKD është munduar që të siguroj numrin e votave të

manipuluara ndërmjet kandidatëve, megjithatë një gjë e tillë ka qenë e pamundur për shkakun se KQZ në pajtim me ligjin ka shkatërruar një pjesë të madhe të kutive të rinumëruara, ndërsa pjesa tjetër konsiderohen si prova materiale të Prokurorit të Shtetit.

Përkundër angazhimit të theksuar në sigurimin e statistikave sa më të sakta dhe të përditësuara, IKD konsideron se statistikat nuk janë të një niveli të kënaqshëm të saktësisë për shkaqe objektive sikurse që është mungesa e bazës të të dhënave automatike apo të përbashkët të policisë, prokurorive dhe gjykatave.

### 3. KORNIZA LIGJORE

Legjislacioni në Republikën e Kosovës ofron mundësi që të ndiqen dhe gjykohen të gjitha llojet e manipulimeve të zgjedhjeve, të cilat janë kryer deri më tash në proceset zgjedhore të organizuara në vend. Rregullat rreth procedurave, të drejtave, detyrimeve dhe ndalesave për zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Kosovë, të cilat mund të kalojnë në sferën penale përcaktohen në dy ligje, atë për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës.<sup>13</sup>

Kodi Penal i Republikës së Kosovës mbetet baza e legjislacionit penal për sanksionimin e veprimeve kriminale në zgjedhje, i cili u ka kushtuar rëndësi të veçantë këtyre veprave, të cilat përcaktohen në nenet 176, 177, 178, 179, 180 dhe 181. Këto nene sanksionojnë veprimet kriminale ndaj të gjithë personave të cilët në çfarëdo mënyre pengojnë votuesit që të ushtrojnë të drejtën e votës, ndërmarrin çfarëdo veprimtarish korruptive, përdorin dhunë në ditën e votimit, votojnë disa herë të njëjtit votues, zbulojnë votën e fshehtë, mashtrojnë në votime dhe asgjësojnë në forma të ndryshme dokumentet e votimit. Dënimet e parapara në këto dispozita ligjore parashohin dënime me gjobë, kusht dhe burgim efektiv deri në pesë (5) vjet. Bazuar në format e krimeve të zgjedhjeve që janë kryer në Kosovë, rezulton se kjo kornizë nuk ka mangësi për të përkufizuar të gjitha veprimet kriminale rreth procesit të zgjedhjeve, prandaj ligjvënësi në Kodin Penal këto vepra i ka kategorizuar tek veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut.<sup>14</sup>

Në zgjedhjet e organizuara në Kosovë në vitin 2010 dhe rivotimet në janar 2011, manipulimet në procesin e zgjedhjeve përshkallëzuan dhe në te u përfshinë numër enorm i komisionerëve të cilët kryen veprime kriminale. Masa e përfshirë dëshmon se këto krime nuk kanë mundur të kryhen në suaza individuale dhe se pas këtyre ekzekutuesve të krimeve kanë qëndruar organizatorët, të cilët i kanë financuar, shtyrë dhe nxitur ata në këto veprime. Shumica e komisionerëve akuzohen për veprën penale nenin 180, “mashtrimi në votime”, i cili përkufizon se: “Kushdo që i falsifikon rezultatet e zgjedhjeve apo të votimeve në Kosovë duke shtuar, hequr apo shlyer votat a nënshkrimet, duke i numëruar në mënyrë jo të saktë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë rezultatet e zgjedhjeve në dokumentet zgjedhore apo këtë e kryen në ndonjë mënyrë tjetër ose i publikon rezultatet e zgjedhjes a të votimit që nuk i përgjigjen votimit të kryer dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet”.<sup>15</sup> Tutje, korniza ligjore ka mundësuar që të

---

<sup>13</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligji numër 03L-073, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 5 qershor 2008. Po ashtu, Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji numër 03L-072, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.

<sup>14</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XVI: Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, Kuvendi i Republikës së Kosovës, prill 2003.

<sup>15</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 180 Mashtrimi në votime, Kuvendi i Republikës së Kosovës, prill 2003.

dysshuarit, sikurse që është rasti i shtatë komisionerëve nëpër vendvotime, të akuzohen sipas nenit 23 Bashkëkryerje të Kodit Penal të Kosovës.

Ndërsa, që një vepër penale të ndiqet sipas nenit 274 Krimi i Organizuar i Kodit Penal varet nga lartësia e dënimit, duhet të ketë strukturë të grupit që kryen veprën penale si dhe qëllim për kryerjen e asaj veprë, i cili duhet të jetë përfitimi i drejtpërdrejt ose i tërthortë i dobisë tjetër pasurore a financiare.<sup>16</sup> Kodi Penal i Kosovës ka mangësi në drejtim të sqarimit të termeve juridike, pasi mungojnë interpretimet për disa prej termeve kyçe. “Dobia tjetër pasurore” nuk figuron fare në shprehjet e Kodit Penal, duke lënë kështu mundësinë e interpretimit në vullnetin e zbatuesve të ligjit.

IKD vlerëson se gjashtë nenet që sanksionojnë veprimet kriminale që ndërlidhen me zgjedhjet në Kodin Penal përkufizojnë mjaftueshëm të gjitha veprimet dhe mënyrat e kryerjes së këtyre veprave penale rreth procesit të zgjedhjeve. Megjithatë, neni 180 i Kodit Penal është absurd, pasi që dënimi primar në këtë dispozitë përcaktohet me gjobë ndërsa lartësia e dënimit sekondar është pesë vite burgim. Mundësia e shqiptimit të dy lloj dënimeve nuk është harmonizuar me rrezikshmërinë e kryerjes së kësaj veprë penale. IKD konsideron se dënueshmëria për këto vepra penale duhet të jetë kulumative ose vetëm me dënim me burgim efektiv. Draft-Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka adresuar këto probleme dhe ka avancuar dispozitat të cilat ndërlidhen me veprat penale kundër të drejtave të votimit. Në Draft-Kodin Penal, dënimet parashihen kryesisht me burgim efektiv.

---

<sup>16</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 274, “Krimi i Organizuar”. Kapitulli XXIII: Veprat Penale Kundër Pasurisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, prill 2003.

## 4. POLITIKA E NDJEKJES

Duke pasur parasysh dështimin në ndjekjen e krimeve të zgjedhjeve në të kaluarën, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010 dhe rivotimit në vitin 2011, Prokurori i Shtetit kishte shpallur ndjekjen e manipulimit të zgjedhjeve si lëndë me prioritet.<sup>17</sup> Dy burimet kryesore të informatave për manipulimin e zgjedhjeve në fjalë kanë qenë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në vazhdim, PZAP) dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (në vazhdim, QNR), të dyja këto trupa të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vazhdim, KQZ), të cilat së bashku kanë ofruar informata për 854 raste të cilat ndërlidhen me zgjedhjet. Në anën tjetër, Policia e Kosovës (në vazhdim, PK) ka luajtur rol pasiv në hetimin dhe nxjerrjen në shesh të organizatorëve dhe kryesve të këtyre krimeve para, gjatë dhe pas zgjedhjeve. PZAP ka dërguar 142 raste në prokurori publike, për të cilat ka pasur dyshime se janë bërë shkelje, kërcënime, manipulim i votave, apo votim në emër të dikujt tjetër. Në anën tjetër, QNR gjatë auditimit të 890 vendvotimeve, në 712 prej tyre ku janë përfshirë 4,984 komisionerë, ka konstatuar ndryshime të mëdha të rezultateve. Ndërsa PK nuk ka iniciuar ndonjë rast duke aluduar në atë se organet kompetente mbeten PZAP, KQZ dhe Prokurori i Shtetit.

Gjetjet e QNR-së kanë shërbyer si prova të pakontestueshme për prokurorët ngase auditimi i Formularëve të Rezultateve të Kandidatëve (në vazhdim, FRK) ka nxjerrë në pah kryesisht manipulimin e votave të kandidatëve, ku në secilin vendvotim këto rezultate të manipuluara janë nënshkruar nga shtatë komisionerë. Prokurorët duke ndjekur normat për kryerjen e lëndëve kanë shkuar në akuzimin e drejtpërdrejtë të komisionerëve në bashkëkryerje, kryesisht për veprën penale të mashtrimit në votime.<sup>18</sup> Deri më tani, prokurorët kanë akuzuar 1,516 persona, në proces të ngritjes së aktakuzave janë edhe 758 persona të tjerë.<sup>19</sup> Ndërsa, kanë mbetur edhe mbi 300 raste tjera të cilat prokuroritë publike duhet t'i shqyrtojnë. Bazuar në shifrat e ngritjes së akuzave sikurse shihet në tabelën më poshtë, del se për herë të parë Prokurori i Shtetit ka një reagim më adekuat në ndjekjen e veprave që ndërlidhen me zgjedhjet.

**TABELA 1**  
**Rastet e trajtuara nga prokuroritë komunale**

---

<sup>17</sup> IKD intervistë me znj. Laura Pula, Prokurore në Prokurori të Shtetit dhe Koordinatore e lëndëve të zgjedhjeve, maj 2012.

<sup>18</sup> *Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 180 Mashtrimi në votime, dhe Neni 23 Bashkëkryerja*, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, prill 2003.

<sup>19</sup> Po aty.

| 1.<br>Prokuroria<br>Publike<br>Komunale | 2.<br>Numri i<br>lëndëve<br>të<br>pranuara | 3.<br>Ngritja e<br>akuzave |               | 4.<br>Propozim<br>akuzat |               | 5.<br>Hedhja e<br>kallëzimeve<br>penale | 6.<br>Rastet e<br>mbyllura | 7.<br>Aktgjykimet | 8.<br>Aktakuza të<br>konfirmuara | 9.<br>Liruar<br>nga<br>akuza |
|-----------------------------------------|--------------------------------------------|----------------------------|---------------|--------------------------|---------------|-----------------------------------------|----------------------------|-------------------|----------------------------------|------------------------------|
|                                         |                                            | Nr. rasteve                | Nr. personave | Nr. rasteve              | Nr. personave |                                         |                            |                   |                                  |                              |
| Ferizaj                                 | 47                                         | 38                         | 260           | 0                        | 0             | 9                                       | 0                          | 9                 | 9                                | 0                            |
| Prishtinë                               | 160                                        | 30                         | 210           | 19                       | 162           | 12                                      | 16                         | 12                | 19                               | 0                            |
| Gjilan                                  | 58                                         | 40                         | 320           | 0                        | 0             | 0                                       | 27                         | 0                 | 9                                | 1                            |
| Pejë                                    | 47                                         | 36                         | 252           | 0                        | 0             | 10                                      | 0                          | 1                 | 8                                | 0                            |
| Gjakovë                                 | 33                                         | 13                         | 78            | 1                        | 1             | 0                                       | 21                         | 2                 | 14                               | 0                            |
| Mitrovicë                               | 55                                         | 0                          | 0             | 10                       | 13            | 12                                      | 0                          | 6                 | 10                               | 0                            |
| Prizren                                 | 95                                         | 31                         | 217           | 3                        | 3             | 15                                      | 0                          | 5                 | 25                               | 1                            |
| <b>TOTAL:</b>                           | <b>495</b>                                 | <b>188</b>                 | <b>1337</b>   | <b>33</b>                | <b>179</b>    | <b>58</b>                               | <b>64</b>                  | <b>35</b>         | <b>94</b>                        | <b>2</b>                     |

#### **Burimi: Prokurori i Shtetit, 31 mars 2012**

Duke parë se vetëm 94 aktakuza janë konfirmuar nga gjykatat, del se gjykatat nuk janë duke mundur të përcjellin dinamikën e ngritjes së akuzave nga ana e prokurorëve. Një aspekt tjetër pozitiv i punës së prokurorëve ndërlidhet me ankesat të cilat prokurorët janë duke i bërë në të gjitha rastet ku dënimet e Gjykatave Komunale janë me gjobë dhe burg me kusht.

Megjithatë, duke nxituar në nxjerrjen e shifrave, për të dëshmuar suksesin në zgjidhjen e lëndëve, Prokurori i Shtetit ka zbatuar një politikë jo adekuate të ndjekjes për këto raste. Prokurorët kanë përjashtuar mundësinë e ndjekjes së këtyre veprave si krim i organizuar duke i kufizuar ato vetëm në nivelin e Prokurorive Publike Komunale.

### **1.2. Manipulimi i votave të kandidatëve**

Manipulimi i votave gjatë zgjedhjeve të përgjithshme 2010 dhe procesit të rivotimit në janar 2011 është fokusuar tek votat e kandidatëve për deputet brenda partive politike.<sup>20</sup> Madje, komisionerët ishin tregtuar nga njëra parti në tjetrën ashtu që të përmbushnin misionin për të siguruar vota për kandidatë të caktuar.<sup>21</sup> Deklarimet publike të krerëve institucional dhe partiak se votat janë vjedhur nga militantët për kandidatë të caktuar dhe se vjedhjet kanë qenë brenda partive janë denoncuar edhe zyrtarisht në PZAP. Një nga personat që është ankuar në PZAP ishte kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (në vazhdim, PDK) z. Gani Koci, i cili pretendonte se rezultatet e shënuara në formularë ishin imponuar nga persona të caktuar sikurse shkruhet në ankesë:

<sup>20</sup> IKD intervista me anëtarët dhe zyrtarët e KQZ-së, përfaqësues të partive politike, prokurorë publik, dhe gjykatës, prill-maj 2012.

<sup>21</sup> IKD intervista me z. Dardan Molliqaj, Sekretar organizativ i Lëvizjes Vetëvendosje, dhe z. Burim Ramadani, Sekretar i përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, maj 2012.

*“Komisionerët në Qendrat e Votimit 2103b-Likoc, 2110b-Vojnik, 2113b-Leqinë, 2114b-Runik, 2121b-Arbëri e Poshtme, 2122b-Makërmal, 2106b-Klinë e Epërme, 2102b-Qubrel, 2132b-Baks, 2123b-Izbicë, 2109b-Krasaliq, dhe qendra të tjera, kanë manipuluar votat të cilat i përkasin atij [Gani Koci-t], duke i vendosur për kandidatë të tjerë. Sipas parashtruesit të ankesës [Gani Koci-t] të gjithë formularët përfundimtar janë plotësuar në bazë të një liste të imponuar nga persona të caktuar. [...] Gjithashtu sipas parashtruesit të ankesës [Gani Koci-t] në bisedat që ka pasur me komisionarët dhe vëzhguesit, del se mbi ta është bërë presion për të heshtur dhe për të vepruar sipas diktatit të caktuar zyrtar.”<sup>22</sup>*

Kandidati tjetër i PDK-së z. Murat Musliu kishte raportuar gjithashtu për manipulim të rezultateve në bazë të urdhrave të cilët kishin ardhur nga lartë, ku në deklarinimin e tij publik është shprehur:

*“Jam i gatshëm të argumentojë përmes xhirimeve filmike, se komisionerët në vendvotimet në Prekaz të Epërm, Klinë të Epërme, Makërmal, Tushilë (me numër të vendvotimit: 2128b/2), Rezallë (vendvotimi 2116b, 00-R, 2116/0,0,1-R), Runik dhe Qubrel dhe në qytetin e Skenderajt, votat e kandidatëve të PDK-së, nuk i kanë numëruar fare, por i kanë vënë në formularë, sipas një liste të imponuar nga persona të fuqishëm dhe zyrtarë të lartë të pushtetit lokal në Skënderaj dhe të PDK-së [...] Qëllimi i këtij organizimi, të udhëhequr nga nënkryetari, ka qenë në radhë të parë grumbullimi i votave për kandidatë të caktuar brenda listës së PDK-së, ku komisionarëve të secilit regjion iu është dhënë lista me emrat, të cilët duhet të votohen, si psh: në Prekaz Xhevahire Izmaku, në Polac Valbona Dibra, në Runik një kandidat jashtë Skënderajt”<sup>23</sup>*

Vjedhja e votave në mes të kandidatëve nga komisionerët nuk ishte një dukuri e izoluar vetëm në rajone të caktuara, por ajo ishte e shprehur gjithandej Kosovës. Për shkak të mospërputhjes të të dhënave në formularët e rezultateve, QNR ishte detyruar që të rinumëronte 890 vendvotime, ku në 712 prej këtyre vendvotimeve kishte rezultuar se ka ndryshime të theksuara të rezultateve. Në figurën 1 janë paraqitur numri i vendvotime të rinumëruara nga QNR nëpër secilën komunë.

---


<sup>22</sup> Shënim: Ankesë e ushtruar nga kandidati për deputet nga radhët e PDK-së z. Gani Koci. PZAP ka vendosur që të hedhë këtë ankesë si të palejuar ngase për rastin në fjalë kishte vendosur në një vendim të mëhershëm, përkatësisht ankesën numër 490/2010. *Ankesa me numër 584/2010, ushtruar me datën 16.12.2010*, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, dhjetor 2010.

<sup>23</sup> Kajtaž Gecaj, “Musliu nga PDK: Na vodhi partia jonë”, *Zëri Info*, 14 dhjetor 2010. Shih <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/14924/musliu-nga-pdk-na-vodhi-partia-jone/> (qasur për herë të fundit 9 maj 2012).

**FIGURA 1**

**890 vendvotimet të cilat QNR i ka rinumëruar për shkak të mospërputhjes të të dhënave**

## Vendvotime



**Burimi: Qendra e Numërimit dhe Rezultateve**



Kandidatë të caktuar kanë akuzuar bashkë-partiakët e tyre se kanë organizuar vjedhjen e votave përmes komisionerëve duke i detyruar ata me urdhra nga lartë që të manipulojnë rezultatet për kandidatët e caktuar. Përkundër këtyre deklarimeve publike dhe denoncimeve të ankesave përmes rrugëve ligjore, prokurorët nuk kanë iniciuar asnjë rast të hetimit rreth tutorëve të cilët kanë organizuar, financuar dhe shtyrë komisionerët që të kryejnë këto krime në zgjedhje.<sup>24</sup> Deklarimet publike përmbajnë informata të cilat përmbushin të gjitha elementet e krimit të organizuar në rastin e manipulimit të votave në zgjedhje. Procesi i rinumërimit të votave kishte nxjerrë në pah se komisionerët kishin manipuluar me mijëra vota për kandidatë të caktuar.<sup>25</sup>

Deri më tani, nuk ka ndonjë raport publik, përveç kalkulimeve të brendshme të partive politike, rreth numrit të votave të kandidatëve para dhe pas rinumërimit të QNR-së. Tutje, institucionet e ndryshme sikurse KQZ apo Prokurori i Shtetit nuk kanë kërkuar që të zbardhet e vërteta rreth votave të manipuluar nga të cilat kanë tentuar të përfitojnë pozitën e deputetit kandidatë të caktuar.<sup>26</sup> Një gjë e tillë do të shërbente për të hapur pistën e hetimeve në drejtim të kandidatëve dhe personave të tjerë të cilët mund të jenë organizatorë të manipulimit të votave.

### 1.3. Krimi i organizuar

Dyshimet për përfshirje të rreth 5,000 komisionerëve në manipulimin e zgjedhjeve dhe ndjekja e të gjitha rasteve si raste të izoluara paraqet një politikë jo adekuate të ndjekjes. Është paradoksale që një numër kaq i madh i komisionerëve të veprojnë në të njëjtën kohë në mënyrë të njëjtë dhe në vende të ndryshme pa pasur ndonjë organizim të mirëfilltë. Pjesa dërrmuese e politikanëve, analistëve, mediave dhe diplomatëve ndërkombëtarë kanë fajësuar partitë politike për organizimin e manipulimit të zgjedhjeve. Megjithatë, në mesin e të dyshuarve për përfshirje në manipulime të

*“Komisionerët janë urdhëruar prej partive politike, prandaj prokurorët do duhej të hetonin se pse i kanë vjedhur ato vota dhe se cilat kanë qenë motivet politike apo dobite pasurore.”*  
Valdete DAKA, Kryetare e KQZ-së

<sup>24</sup> IKD intervistë me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, znj. Laura Pula, Prokurore në Prokurori të Shtetit dhe Koordinatorë për lëndët e zgjedhjeve, z. Aleksandër Lumnezi, Kryeprokuror i Qarkut të Prishtinës, dhe znj. Sevdije Morina, Zëvendëskryeprokurore e Prokurorisë Speciale të Kosovës, prill-maj 2012.

<sup>25</sup> IKD intervistë me anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, maj 2012.

<sup>26</sup> IKD intervistë me znj. Valdete Daka, Kryetare e KQZ-së, maj 2012. Po ashtu, IKD intervistë me znj. Laura Pula, Prokurore në Prokurori të Shtetit dhe Koordinatorë e lëndëve të zgjedhjeve, maj 2012. Shënim: IKD ka kërkuar nga KQZ që t'i lejohet qasja në këto dokumente për të parë se sa vota potenciale janë manipuluar dhe për cilët kandidatë. Kjo kërkesë është aprovuar nga KQZ megjithatë nuk ka prodhuar ndonjë informatë tjetër për shkakun se të gjitha materialet të cilat kanë mbetur pa u shkatërruar janë prova materiale të prokurorëve dhe si të tilla nuk lejohet të hapen, ndërsa, pjesa tjetër është shkatërruar ashtu siç kërkohet me ligj.

zgjedhjeve, nuk gjendet asnjë përfaqësues i lartë i partive politike. Tutje, prokurorët kanë dështuar që të orientojnë dhe zgjerojnë hetimet drejt organizatorëve të manipulimeve, ku një gjë e tillë vërehet nga veprimet e prokurorëve, të cilët nuk kanë tentuar fare të bëjnë një pyetje të vetme se kush i ka shtyrë komisionerët që të manipulojnë rezultatet e votave.<sup>27</sup> Përfaqësues të lartë të partive politike konsiderojnë se komisionerët që janë duke u akuzuar kanë shërbyer si ekzekutues të urdhrave të personave që kanë tentuar të fusin në Parlament kandidatët e caktuar të partive.<sup>28</sup> Qysh në dhjetor të vitit 2010, ishte ngritur dilema nëse këto krime ishin kryer në mënyrë të organizuar, ku eksperti juridik z. Dastid Pallaska pati theksuar:

*“Prokurori i mirë i shqyrton të gjitha mundësitë e mundshme, definitivisht se një komisioner me një fshat të thellë të Kosovës nuk ka kush e di se çfarë interesi me manipulu zgjedhjet dhe definitivisht se prapa tij apo prapa gjithë atyre personave që kanë kry këto vepra penale kanë ekzistuar persona që i kanë nxitur, që i kanë shtyrë, financuar, dhe i kanë ndihmuar para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale. Të gjitha këto përbëjnë elemente të cilat duhet të shqyrtohen dhe assesi të paragjykohet se a ka ekzistuar apo jo por duhet të shqyrtohen provat, të cilat mund të qojnë deri te konkludimi se ndoshta ka pasur ndonjë ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e këtyre veprave penale”<sup>29</sup>*

Financimi i dyshimtë i ndërsjellë i partive dhe bizneseve, dështimi institucional që ka krijuar mundësi të pastër për manipulim në ditën e votimit, numri enorm i komisionerëve të përfshirë dhe akuzuar për manipulim të votave dëshmojnë për një parapërgatitje dhe organizim kriminal për të kryer krime në ditën e zgjedhjeve, duke bërë kështu që ky lloj krimi të bie në domenin e “krimit të organizuar”. Për të forcuar më shumë këtë bindje, ish ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi pati theksuar se manipulimet kanë ardhur pikërisht nga individë të cilët kanë dhënë direktiva se kush të shkojë në Kuvendin e Kosovës:

*“Komisionerët që në fakt janë përfaqësues të partive politike dhe sigurisht që përgjegjësinë për këtë e kanë individë të caktuar të niveleve të ndryshme të subjekteve politike që si duket kanë dhënë direktiva të gabuara me qëllim për të avancuar kuadra të veçantë jo që kanë marrë besimin e qytetarëve të Kosovës por kuadra që kanë dashtë të hyjnë në Kuvendin e Kosovës, mbi bazën*

---

<sup>27</sup> Aktgjykim ndaj tetë të akuzuarve për veprën penale mashtrim në votime, neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Aktgjykimi numër P.nr.163/2011, Gjykata Komunale në Glogoc, 27 maj 2011. Po ashtu, Aktgjykim ndaj gjashtë të akuzuarve për veprën penale mashtrim në votime, neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Aktgjykimi numër AP.nr.41/2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, 7 maj 2012.

<sup>28</sup> IKD intervista me z. Adem Grabovci, Shef i Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Isa Mustafa, Kryetar i LDK-së, z. Burim Ramadani, Sekretar i Përgjithshëm i AAK-së, dhe z. Dardan Molliqaj, Sekretar organizativ i VV-së, maj 2012.

<sup>29</sup> Emisioni “Drejtësia në Kosovë”, Radio Televizioni i Kosovës, dhjetor 2010.

*e vullnetit të komisionerëve të partive politike. Dhe këtu ka filluar deformimi i këtij procesi zgjedhor.”<sup>30</sup>*

Shqetësim të ngjashëm për klasën politike dhe proceset zgjedhore në Kosovë ndan edhe Ambasadori Amerikan në Kosovë z. Christopher Dell, i cili shprehet:

*“Të gjithë anëtarët e partive politike bëjnë me gisht nga njëri-tjetri duke thënë se ata janë të korruptuarit. Por, disa prej atyre që bëjnë me gisht janë po atë që gatshëm të mbushin kutitë e votimit, t’ua gjejnë anëtarëve të familjeve së tyre ndonjë vend të mirë pune në qeveri dhe t’ua mundësojnë miqve të tyre marrjen e kontratave të leverdishme afariste kur kjo gjë është në interesin e tyre. Më lejoni të jem i qartë: nuk po përjashtoj asnjë parti nga ky pohim”<sup>31</sup>*

Pothuajse çdo segment i shoqërisë është i pajtimit se këto manipulime të zgjedhjeve “nuk kanë qenë sporadike, por se vjedhja ka qenë sistematike dhe nuk mund të qëndroj pa pasur një rrjet”.<sup>32</sup> Krimi i organizuar është definuar sipas nenit 274 të Kodit Penal të Kosovës. Ashtu që vepra të cilësohet si krim i organizuar, duhet të jetë krim i rëndë i dënueshëm së paku katër vite burgim, grupi duhet të jetë i strukturuar për përfitim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë pasurore a financiare, grupi i strukturuar i përbërë nga tre apo më shumë persona ekziston për një kohë të caktuar dhe nuk është formuar rastësisht për kryerje të atypëratyshme të veprës penale, megjithatë nuk është e thënë që të jetë grup formal me role të ndara dhe të ketë vazhdimësi apo strukturë të zhvilluar.

Pavarësisht elementeve të ndryshme të cilat kanë sugjeruar se manipulimi i votave mund të vlerësohet si krim i organizuar, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në vazhdim, PSRK) nuk ka marrë mundin që të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes në hetimin e këtyre rasteve.<sup>33</sup> IKD vlerëson se me këtë qasje, PSRK ka dështuar të përmbushë detyrat që burojnë nga mandati ekskluziv për të luftuar krimin e organizuar. Në vazhdim do të shpjegohet se si është plotësuar secili kusht që manipulimet në zgjedhje të hetohen edhe si krim i organizuar.

### *1.3.1. Grup i strukturuar*

Ky është një kusht i cili është plotësuar pothuajse në të gjitha rastet, pasi që në çdo vendvotim janë përfshirë nga shtatë komisionerë të cilët kanë bashkëvepruar për të kryer

---

<sup>30</sup> Intervista e ish ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi dhënë televizionit Top Channel, 23 dhjetor 2010.

<sup>31</sup> Fjalimi i Ambasadorit Amerikan në Kosovë z. Christopher Dell me rastin e ceremonisë së “Programit fillestar edukativ ligjor”, Instituti Gjyqësor i Kosovës, 30 mars 2012.

<sup>32</sup> IKD intervistë me z. Avni Zogiani, Bashkë-themelues i organizatës Çohu, qershor 2012.

<sup>33</sup> IKD intervistë me znj. Sevdije Morina, Zëvendëskryeprokurore e PSRK-së, maj 2012.

manipulimet. Kryetari i Gjykatës Supreme z. Fejzullah Hasani thotë se “nuk përjashtohet mundësia që t’i ketë primesat e grupit të strukturuar, ku ka ekzistuar një marrëveshje, ka ekzistuar hierarki, janë marrë urdhrat, dhe ku janë zbatuar urdhrat. Do me thanë ajo struktura hierarkike ka qenë e ndërtuar taman siç e kërkon kjo [dispozitat ligjore për krim të organizuar]”.<sup>34</sup> Po ashtu, Kryeprokurori i Shtetit thekson se manipuluesit e zgjedhjeve hyjnë në kategorinë e grupit të strukturuar, të cilët në bashkëkryerje qenësisht me vetëdije të plotë kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale.<sup>35</sup>

Të dyshuarit e përfshirë në këto manipulime kanë pasur rolet e caktuara për të cilat janë marrë vesh paraprakisht apo ditën e votimeve. Komisionerët e vendvotimeve e kanë shumë të vështirë që të nxjerrin arsye të cilat do të vendosnin në pikëpyetje përfshirjen apo jo të tyre në manipulimin e rezultateve, pasi që të gjithë kanë nënshkruar formularët. Kjo gjë ka dhënë dëshmi të pakontestueshme se personat në fjalë kanë qenë në dijeni të plotë për veprimet që kanë ndërmarrë.

### *1.3.2. Dënueshmëria më e lartë se katër vjet*

Për manipulimet e zgjedhjeve pjesa dërrmuese e akuzave të ngritura kanë të bëjnë me nenin 180 Mashtrim në votime të Kodit Penal. Kjo vepër dënohet deri në pesë vjet burgim, gjë që mundëson plotësimin e njërit nga kushtet për të qenë vepër që mund të ndërlidhet me Krimin e Organizuar, pasi është krim i rëndë. Pothuajse në të gjitha rastet e ngritjes së aktakuzave, të akuzuar janë të gjithë komisionerët e vendvotimeve në bashkëkryerje. Në çdo vendvotim ka pasur nga shtatë komisionerë të cilët gjithë së bashku janë pajtuar në një apo formë tjetër që të manipulojnë me votat dhe rezultatin përfundimtar, gjë e cila dëshmohet nga procesi i auditimit i zhvilluar nga QNR.

### *1.3.3. Dobia tjetër pasurore*

Dilema kryesore qëndron rreth asaj nëse përfitimi i pozitës së deputetit të Kuvendit është apo nuk është “dobi tjetër pasurore a financiare”. Kodi Penal në asnjë pjesë, përfshirë këtu shprehjet në kod, nuk e përkufizon dobinë tjetër pasurore.

Përpilimi i ligjeve në Kosovë gjithnjë është kritikuar për shkak të procesit të përpilimit, përmbajtjes dhe përkthimit jo adekuat. Për shkaqe të përkthimit të dobët, kemi edhe përkthimin e mangët në versionin shqip të Kodit Penal, që ndërlidhet me njërin nga krimet më të rrezikshme për shoqërinë, sikurse Krimi i Organizuar. Termi në anglisht “financial or

---

<sup>34</sup> IKD intervistë me z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, maj 2012.

<sup>35</sup> IKD intervistë me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, prill-maj 2012.

other material benefit”, në vend se të përkthehet “dobi tjetër pasurore a financiare” është përkthyer “dobi pasurore a financiare”, duke lënë kështu jashtë fjalën “tjetër”. Në vazhdim të punimit do të përmendet vetëm termi “dobi tjetër pasurore a financiare”, pasi që versionin anglisht të Kodit Penal në çdo konflikt apo paqartësi është versioni i zbatueshëm.

Komuniteti i juristëve në Kosovë është i përçarë rreth definimit të dobisë tjetër pasurore në Kodin Penal të Kosovës. Paqartësitë rreth përkufizimit të dobisë tjetër pasurore shtohen

*“Dobia pasurore është dobi materiale dhe jo-materiale. Prandaj, edhe pse në hapin e parë punësimi mund të duket se nuk është, mirëpo më vonë kalon në fitim të parave, pra është dobi pasurore.”*

për shkak të mungesës së komentareve ligjor, në këtë rast komentarin e Kodit Penal të Kosovës. Krerët e sistemit të drejtësisë në Kosovë, deri më tani kanë preferuar që të përkufizojnë “dobinë tjetër pasurore a financiare” sipas interpretimit të ngushtë, ku përfshihen vetëm përfitimet materiale apo financiare që rezultojnë direkt nga kryerja e veprës penale, duke insistuar se fitimi i pozitës së

deputetit paraqet përfitim por jo “dobi tjetër pasurore”. Kryeprokurori i Shtetit dobinë tjetër pasurore e përkufizon si fitim të pastër i cili paraqet shtimin e pasurisë të cilën kryesi e ka arritur me kryerjen e veprës penale.<sup>36</sup> Kryetari i Gjykatës Supreme ndanë të njëjtin mendim, duke theksuar se krimi i organizuar kërkon përfitime financiare apo materiale.<sup>37</sup> Një interpretim i tillë shërben për këto autoritete që të kufizohen dhe të mos përfshijnë një sërë dobish tjera të cilat do të mund të përkufizoheshin në kuadër të dobisë tjetër pasurore. Në këtë drejtim, dobite tjera sikurse punësimi, avancimi, apo privilegjet, lihen jashtë pasi që fillimisht nuk paraqesin pasuri të pastër financiare apo materiale por që krijojnë mundësi për të sjellë dobi tjetër pasurore në të ardhmen. Ndryshe nga krerët institucioneve qendrore të sistemit të drejtësisë, kolegë të tyre vendorë e ndërkombëtarë punësimin, avancimin, dhe privilegjet, i përkufizojnë në kuadër të “dobive tjera pasurore”.<sup>38</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit (në vazhdim, AKK), që është një nga institucionet që merret drejtpërdrejtë me luftimin e korrupsionit në kuadër të së cilës hynë të gjitha dobite të cilat përkufizohen në kuadër të veprave korruptive, “dobinë tjetër pasurore” e sheh si dobi materiale dhe jo-materiale.<sup>39</sup>

*“Shprehja “dobi pasurore” në vete ngërthen dobinë materiale dhe jo materiale”*  
- Hilmi ZHITIA, bashkë-autorë  
i Draft-Komentarit të parë të  
Kodit Penal të Kosovës

Dilema rreth përkufizimit të “dobisë tjetër pasurore” është evidente edhe në draft komentarin e parë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili është duke u përpiluar nga tre autorë, Prof. Dr. Ismet Salihu, Dr. Fejzullah Hasani dhe Mr. Hilmi Zhitia. Të tre autorët gjatë komentimit të dispozitave të caktuara të Kodit Penal në të cilat është hasur “dobia

<sup>36</sup> IKD intervistë me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, prill-maj 2012.

<sup>37</sup> IKD intervistë me z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, prill 2012.

<sup>38</sup> IKD intervistë me prokurorë special vendor dhe ndërkombëtarë, ekspertë juridik, ish-Kryeprokuror të Prokurorisë Publike të Kosovës, bashkë-autorë të komentarit të Kodit Penal, maj 2012.

<sup>39</sup> IKD intervistë me z. Hasan Preteni, Drejtor i AKK-së, maj 2012.

tjetër pasurore” kanë bërë interpretime me dallime përmbajtësore rreth këtij termi juridik. Ndryshe nga bashkë-autorët e tjerë, ish-Kryeprokurori i Prokurorisë Publike të Kosovës z. Hilmi Zhitia thekson se dobia tjetër pasurore në interpretimin ekstensiv (apo të gjerë) përfshinë dobinë materiale dhe jo-materiale, duke bërë kështu që mundësia e marrjes së pozitës së deputetit të Kuvendit të kualifikohet në kuadër të “dobisë tjetër pasurore”.<sup>40</sup>

Në kërkim të një interpretimi sa më adekuat të kësaj dispozite ligjore, IKD ka hulumtuar dokumente të ndryshme ndërkombëtare, me fokus të veçantë në interpretimin e bërë në dokumentet e Kombeve të Bashkuara (në vazhdim, OKB). Ky fokus është bërë qëllimisht pasi që Kodi Penal i Kosovës është punuar gjatë kohës kur vendi është qeverisur nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në vazhdim, UNMIK). Gjetjet e IKD-së tregojnë se në “dobi tjetër pasurore apo financiare” hynë dobitë materiale dhe jo-materiale. Në këtë drejtim, interpretimi i kësaj shprehje ngërthen në vete përveç dobive materiale edhe dobitë tjera sikurse shpërblim, avantazh, privilegj apo shërbim (përfshirë këtu ato seksuale apo tjera).<sup>41</sup> Më poshtë është paraqitur krahasimi i interpretimit të dy rasteve të ngjashme, të cilat paraqesin përfitim të mundësisë në njërën anë të punësimit e në anën tjetër të kalimit të kufirit.

**TABELA 2**

**Tabela krahasuese e interpretimit të “dobisë tjetër pasurore a financiare”**

| <b>Rasti i Kosovës<sup>42</sup></b>                                                                                                                     | <b>Kombet e Bashkuara<sup>43</sup></b>                                                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Shpjegimi i rastit:</i><br>Përfitimi i pozitës së deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës përmes manipulimit të votave.                        | <i>Shpjegimi i rastit:</i><br>Keqpërdorimi i identifikimit për përfitime personale apo të organizatës.                                                                                                               |
| <i>Interpretimi i Kryeprokurorit të Shtetit:</i><br>Përfitimi i pozitës së punës në mënyrë të kundërligjshme nuk paraqet dobi pasurore por dobi tjetër. | <i>Interpretimi:</i><br>Termi “dobi tjetër pasurore apo financiare” është mjaftë i gjerë dhe përfshinë po ashtu përfitimet jo-financiare sikurse në rastin konkret përfshinë sigurimin e hyrjes në një shtet tjetër. |
| <i>Përfundimi:</i><br>Mundësia e krijuar në mënyrë të kundërligjshme nuk paraqet “dobi tjetër pasurore a financiare”.                                   | <i>Përfundimi:</i><br>Mundësia e krijuar në mënyrë të kundërligjshme paraqet “dobi tjetër pasurore a financiare”.                                                                                                    |

<sup>40</sup> IKD intervistë me z. Hilmi Zhitia, bashkë-Autorë i Draft-Komentarit të parë të Kodit Penal të Kosovës dhe ish-Kryeprokuror i Prokurorisë Publike të Kosovës, maj 2012.

<sup>41</sup> *Ligji model kundër trafikimit me migrantë* (New York: Kombet e Bashkuara - Zyra rreth Drogave dhe Krimit, 2010), f. 13-15.

<sup>42</sup> IKD intervistë me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, prill-maj 2012.

<sup>43</sup> *Doracaku për Krimet që ndërlidhen me krimet rreth Identitetit* (New York: Kombet e Bashkuara – Zyra rreth Drogave dhe Krimit, 2011).

Në përfundim, “dobia tjetër pasurore a financiare” është një shprehje e cila në vete ngërthen një sërë dobish por assesi nuk kufizohet vetëm në përfitime materiale sikurse që është duke u interpretuar tani nga krerët e institucioneve të drejtësisë. Komentarët e OKB-së për krimet të cilat ndërlidhen me krimin e organizuar, na bëjnë që të kuptojmë se “dobia tjetër pasurore a financiare” duhet të interpretohet në kuptimin e gjerë duke përfshirë dobitë materiale dhe jo-materiale. Krerët e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, termin “dobi tjetër pasurore a financiare” duhet ta interpretojnë në kuptimin e gjerë, duke përfshirë këtu edhe përfitimin e një vendi të punës, sikurse që është rasti me përfitimin e pozitës së deputetit të Kuvendit. Në vazhdim të punimit do të paraqiten dobitë të cilat gjenerohen nga hyrja në politikë.

#### *1.3.4. Dobitë nga hyrja në politikë*

Manipulimi i zgjedhjeve është një problem shumë i ndërlikuar dhe paraqet sfida për t’u zgjidhur lehtë pasi që çështja nuk qëndron vetëm tek udha për përfaqësim të qytetarëve, por është gjithashtu çështje e përfitimeve të ndryshme që burojnë nga pozitat e tilla publike. Përfitimet për politikanët dhe përkrahësit e tyre ndër tjera përfshijnë emërimin dhe punësimin në institucione publike, abuzimin e pozitës zyrtare përmes marrjes së mitos apo përfitimit të dobive tjera pasurore, përpilimit të politikave të cilat i shkojnë për shtati grupeve të caktuara të interesit, si dhe mundësinë që resurset publike të bien në duar të njerëzve të partisë apo atyre të afërt me partinë.<sup>44</sup> Andaj, interesat e tjera të cilat nuk ndërlidhen me përfaqësimin politik të qytetarëve, bëjnë që anëtarët e partive të jenë edhe më të etur për pushtet, sidomos në vendet sikurse Kosova, ku institucionet politike e financiare janë në konsolidim e sipër.

Një kalkulim i të ardhurave të 120 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nxjerr në pah se një deputet mesatarisht për një mandat katër vjeçar dhe një vit pas përfundimit të mandatit vjel 95.7 mijë euro si kompensim për punën e deputetit dhe periudhën përcjellëse prej një viti deri sa të gjej një burim tjetër të të ardhurave.<sup>45</sup> Tutje, përfitimet e deputetëve nuk ndalen vetëm tek paga bazë dhe kompensimet tjera, por ato përfshijnë gjithashtu mbulim të shpenzimeve tjera sikurse që janë komunikimi e transporti. Në vitin

---

<sup>44</sup> Verena Blechinger, *Korrupsioni dhe Partitë Politike* (Washington: Management Systems Internaional dhe USAID, nëntor 2002), f. 3.

<sup>45</sup> IKD ka llogaritur kompensimin dhe shtesat e 107 deputetëve të paraqitura në deklaratimet e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, ndërsa për 13 deputetë tjerë është llogaritur në bazë të mesatares të 107 deputetëve tjerë. Në bazë të nenit 14 Përfitimet financiare dhe materiale të deputetit të Ligjit për Deputet parashihet që deputeti ka të drejtë për kompensim të pagës bazë (neni 15), pagë kalimtare pas përfundimit të mandatit (neni 16, ku deputeti kompensohet deri në një vit pas përfundimit të mandatit të deputetit), kompensimi për pjesëmarrje në seanca dhe në takime të komisioneve, kompensim për funksionet parlamentare, kompensim i shpenzimeve mujore, pensionet suplementare, dhe të drejta tjera të përcaktuara me ligj. *Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji numër 03/L-111*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 korrik 2010.

2010, deputetët e Kuvendit ishin shfaqur të etur për të siguruar të ardhura tjera nga buxheti i Kosovës duke përfshirë në Ligjin për Deputet “pensionin suplementar” prej 50%, 60% dhe 70%, i cili do u takonte nga mosha 55 vjeçare.<sup>46</sup> Megjithatë, Gjykata Kushtetuese kishte cilësuar këtë “pension suplementar” të deputetëve si “dhuratë pa qëllim publik qartazi të përcaktuar” dhe kishte theksuar se është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe dispozitat e tilla i ka konsideruar si të pavlefshme dhe pa fuqi ligjore.<sup>47</sup> Tabela më poshtë paraqet të ardhurat direkte të cilat gjenerohen në forma të ndryshme gjatë dhe një vit pas përfundimit të mandatit.

**TABELA 3**  
**Të ardhurat e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

| #             | LLOJET E PAGAVE DHE KOMPENSIMEVE                             | SHUMA PËR NJËSI (EURO) | NJËSI | PËR 120 DEPUTETË (EURO) | PËR DEPUTET (EURO) |
|---------------|--------------------------------------------------------------|------------------------|-------|-------------------------|--------------------|
| 1             | Paga bazë dhe kompensimet tjera për katër vite <sup>48</sup> | 2,296,519              | 4     | 9,186,076               | 76,551             |
| 2             | Kompensimi kalimtar për një vit <sup>49</sup>                | 2,296,519              | 1     | 2,296,519               | 19,297             |
| <b>TOTAL:</b> |                                                              |                        |       | 11,482,595              | 95,688             |

**Burimi: Kalkulim i IKD-së sipas Ligjit për Deputet duke u bazuar në deklaratimet e pasurisë në AKK**

Përveç kompensimit që marrin për punën e tyre, deputetët e Kuvendit kanë fuqi shumë të madhe për të marrë vendime të cilat kthehen në përfitime për ta apo për grupe të caktuara të interesit. Më lartë u përmend rasti kur deputetët kishin miratuar një ligj i cili do të krijonte të ardhura të majme në emër të “pensionit suplementar”. Përveç këtij ligji i cili do të krijonte të ardhura në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë për deputetët, në Kuvendin e Kosovës çdo seancë shqyrtohen ligje, projekt-ligje, kërkesa, dhe dokumente tjera të cilat janë mjaftë të rëndësishme për rregullimin e çështjeve të ndryshme. Për shembull, në seancën e 6 prill 2012 të Kuvendit, gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për lojërat e fatit, deputetët disa herë vendosën në pikëpyetje interesat personale të cilat disa deputetë mund të kishin rreth amendamenteve të caktuara. Insistimi i vazhdueshëm i deputetit Shaip Muja

<sup>46</sup> Me 4 qershor 2010, deputetët e Kuvendit me 74 vota për kishin miratuar Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, ku sipas të cilit deputeti gëzon pension suplementar nga mosha 55 vjeçare, dhe se ky pension për një deputet që ka shërbyer një mandat është 50% e pagës bazë, ndërsa për më shumë mandate shkon deri në lartësinë e 70% të pagës bazë. Sipas një raporti të vitit 2007 të Entit të Statistikave të Kosovës, jetëgjatësia mesatare në Kosovë është 69 vjet, andaj duke llogaritur se deri në atë moshë deputeti i Republikës së Kosovës do të përfitonte nga pensioni suplementar del se një deputet do të fitonte edhe 133 mijë euro gjatë kohës së pensionit. Tutje, neni 27 mbi Pensionin familjar parasheh që në rast të vdekjes, familjarëve iu takon 70% e pensionit. *Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji numër 03/L-111*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 korrik 2010. *Të moshuarit në Kosovë 100 e më shumë vjeç* (Prishtinë: Enti i Statistikës së Kosovës, dhjetor 2007), f. 11.

<sup>47</sup> *Aktgjykim në rastin numër KO 119/10, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafit 1.6, neni 22, neni 24, neni 25 dhe neni 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, numër 03/L-111*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 8 dhjetor 2011.

<sup>48</sup> Secili deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës gëzon pagën bazë si dhe kompensimet tjera që ndërlidhen me pjesëmarrje në funksione të ndryshme në Kuvendin e Kosovës. *Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji numër 03/L-111*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 korrik 2010.

<sup>49</sup> Sipas nenit 16 mbi Kompensimin kalimtar, për 12 muaj pas përfundimit të mandatit, deputeti i cili nuk realizon të hyra financiare nga ndonjë burim tjetër, vazhdon të marrë pagën bazë. *Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Ligji numër 03/L-111*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 korrik 2010.



për amendamente të caktuara, është cilësuar si i shtyrë nga motive për përfitime personale, ku deputeti Latif Gashi thekson se “nuk e kam asnjë dyshim që deputeti Muja ka ndonjë interes personal nga kjo që e kërkon me çdo kusht”, ndërsa nënkryetari i Kuvendit Xhavit Haliti tha “... përgëzoj pronarët e lojërave të fatit që paskan lobuar shumë e shumë mirë dhe t’i përgëzoj edhe ata që kanë interesa këtu në këtë sallë”, përderisa anëtarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa u shpreh e çuditur me interesimin e madh, të papritur, dhe paraqitjen për herë të parë të deputetit në fjalë për intervenim për amendamente në komisionin përkatës.<sup>50</sup> Ky është vetëm një rast i cili ilustron se si pozita e deputetit krijon mundësi tjera për të ndikuar dhe për të krijuar përfitime qoftë për vete apo për grupe të caktuara të interesit.

Përfitimet e drejtpërdrejta për kandidatët e partive politike si dhe përkrahësit e tyre fillojnë në Kuvend dhe pastaj nuk kanë të ndalur. Deputetët janë ata të cilët kanë fjalën kryesore në formimin e qeverisë. Koalicioni qeverisës i formuar pas zgjedhjeve të përgjithshme 2010 ka populluar me njerëz të vet pozita të ndryshme qeveritare: një kryeministër, gjashtë zëvendëskryeministra, 19 ministra, rreth 33 zëvendësministra, dhe shumë pozita tjera të këshilltarëve politik. Këto janë pozitat kyçe të cilat janë mjaftë atraktive për liderët e partive politike si dhe përkrahësit e tyre. Vetëm shpenzimet për paga për këto pozita i kushtojnë buxhetit të Kosovës rreth 2.1 milionë Euro në vit.<sup>51</sup> Në ndërkohë, personat të cilët zënë këto pozita e kanë të alokuar buxhetin shtesë për shpenzime tjera që ndërlidhen me komunikim, reprezentacion, përdorim të automjeteve, dhe qasje në resurse tjera. Megjithatë, çështja më brengosëse mbetet administrata publike, ku kemi 70 mijë të punësuar në shërbimin civil të Kosovës.<sup>52</sup> Partitë politike kanë shfrytëzuar administratën publike si “instrument të punësimit të njerëzve me prejardhje të caktuar politike”,<sup>53</sup> dhe si e tillë ka shërbyer për “të përmbushur apetitet për shpagim të subjekteve politike”.<sup>54</sup> Rasti i fundit i punësimit të z. Naim Maloku, ish-këshilltar politik i ish-Presidentit Pacolli, në pozitën e Drejtorit të Burgut të Sigurisë së Lartë, ku oferta dhe pajtimi për të marrë këtë pozitë ishin bërë para përfundimit të konkursit,<sup>55</sup> pasqyron një praktikë të akomodimit në administratën publike të mbështetësve të koalicioneve politike

---

<sup>50</sup> *Transkript i Seancës Plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 29 mars, 30 mars, 5 prill dhe 6 prill 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës.*

<sup>51</sup> *Nevoja për miratimin e Ligjit për Qeverinë* (Prishtinë: Instituti GAP, qershor 2011).

<sup>52</sup> *Struktura gjinore dhe etnike e të punësuarve në shërbimin civil të Kosovës* (Prishtinë: Ministria e Administratës Publike), f. 1.

<sup>53</sup> Prononcim i Sekretarit të Odës Ekonomike të Kosovës z. Berat Rukiqi, në emisionin “Jeta në Kosovë”, 23 shtator 2010, <http://www.jetanekosove.com/sq/Reportazhe-Hulumtuese/Sa-sh%C3%ABrbyes-civil-ka-Kosova--342> (qasur për herë të fundit 15 maj 2012).

<sup>54</sup> Ligjëratë e Ministres së Integrimeve Evropiane znj. Vlora Çitaku. Jeton Llapashtica, “Çitaku: Politika po e “dhunon” administratën”. *Zëri Info*, 19 maj 2012. Shih <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/49604/citaku-politika-po-e-dhunon-administraten/> (qasur për herë të fundit më 27 maj 2012).

<sup>55</sup> “Maloku – drejtor me konkurs të kurditur, Kuqi mohon”. *Koha Net*, 23 maj 2012. Shih <http://www.koha.net/index.php?page=1,13,100509> (qasur për herë të fundit 7 qershor 2012).

qeveritare. Tutje, partitë politike popullojnë bordet e ndërmarrjeve publike me anëtarët e tyre,<sup>56</sup> të cilët fitojnë të ardhura marramendëse deri afër 30 mijë Euro në vit.<sup>57</sup>

Përveç punësimeve, pjesë tjetër shqetësuese dhe burim i përfitimeve për pushtetarët vazhdon të mbetet prokurimi publik. Tenderët vazhdojnë të jenë shqetësim në masë të madhe në kontekst të korrupsionit.<sup>58</sup> Në ekonominë e varfër të Kosovës, tenderët e institucioneve publike janë burim ekzistencial i të ardhurave për bizneset vendore. Një nga rastet e fundit është edhe konfrontimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit z. Ramadan Muja me përkrahësit e fushatës së tij, të cilët pretendojnë se z. Muja nuk është duke i përmbushur premtimet për të shpërblyer këta përkrahës me projekte të cilat do të sillnin të mira materiale.<sup>59</sup> Rrjedhimisht, ekziston një ndërlidhje kadrovike në mes të politikës dhe biznesit ku përfitimet materiale dhe jo materiale janë të ndërsjella.

#### **1.4. Çështjet tjera që kontribuan në manipulimin e zgjedhjeve**

##### **Financimi i partive politike**

Krimet të cilat ndërlidhen me zgjedhjet nuk fillojnë dhe nuk mbarojnë me ditën e votimeve, por ato përfshijnë faza dhe fenomene të ndryshme, të cilat burojnë nga mënyra e dyshimtë e financimit të partive politike. Financimi i partive politike më së miri mund të observohet gjatë fushatave parazgjedhore, ku subjektet politike kanë nevojë për mjete financiare për të zhvilluar propagandën dhe mobilizimin e përkrahësve. Financimi i partive politike në Kosovë bazohet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike. Në vitin 2012, me ndryshimet e Ligjit mbi financimin e subjekteve politike, është rritur buxheti nga i cili do të përfitojnë partitë politike, nga 0.17% në 0.34% të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës.<sup>60</sup> Përveç këtij buxheti, subjektet politike përfitojnë edhe nga fondi për fushatat elektorale, i cili arrin deri në 0.05% të buxhetit të Kosovës.

Mungesa e mjeteve të mjaftueshme të cilat ndahen nga buxheti i Kosovës, i shtyn partitë që të zgjasin dorën tek përkrahësit e tyre nga sfera e biznesit dhe qytetarët e rëndomtë.

---

<sup>56</sup> Florent Spahija dhe Sanije Jusufi, "Bordet si mundësi e militantëve". *Gazeta Jeta në Kosovë*, 5 dhjetor 2011. Shih <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,3,796> (qasur për herë të fundit 27 maj 2012).

<sup>57</sup> Enis Velu, "Sheikët" e kompanive publike". *Zëri Info*, 21 shkurt 2012. Shih <http://www.zeri.info/artikulli/2/8/44248/sheiket-e-kompanive-publike/> (qasur për herë të fundit më 22 maj 2012).

<sup>58</sup> *Raporti për Zgjerim për Kosovën, Rezoluta e Parlamentit Evropian e 29 mars 2012 mbi Procesin e Integritetit Evropian të Kosovës (2011/2885 (RSP))*, (Parlamenti Evropian, 29 mars 2012).

<sup>59</sup> Kastriot Jahaj, "Shpague financuesit e fushatës me tender". *Gazeta Jeta në Kosovë*, 19 mars 2012. Shih <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,3,1671> (qasur për herë të fundit më 15 maj 2012).

<sup>60</sup> *Ligji për financimin e subjekteve politike, ligji numër 03/L-174, neni 7 mbi fondin për mbështetjen e subjekteve politike*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 21 tetor 2010. Po ashtu, *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit numër 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, ligji numër 04/L-058, neni 2*, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 12 janar 2012.

Raportet e auditimit të subjekteve politike tregojnë për përkrahje financiare e cila bëhet kryesisht gjatë periudhës së fushatës parazgjedhore dhe se subjektet politike nuk kanë ndonjë bazë të përkrahjes sistematike.<sup>61</sup> Përveç përkrahjes nëpër kanalet ligjore, partitë politike marrin fonde edhe nëpër rrugë tjera gjë që pasqyrohet me mospërputhje të shpenzimeve reale të tyre me të hyrat e deklaruar.<sup>62</sup> Raportet financiare të partive politike mbesin problematike për shkak të zvarritjeve të vazhdueshme për t'i dorëzuar ato në KQZ.<sup>63</sup> Mungesa e financimit të qëndrueshëm të partive politike, në njërin anë, dhe ekonomia e brishtë, në anën tjetër, bëjnë që politika dhe biznesi të jenë të pandashëm.<sup>64</sup> Të parët luftojnë për pushtet përmes të cilit shpagojnë financuesit e fushatave, në këto raste bizneset, ku e gjithë kjo zhvillohet jashtë kornizave ligjore. Andaj, pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe formimit të institucioneve përkatëse, hasim në veprimtari korruptive. Fenomeni i shpagimit të bizneseve me tenderë publik është vërejtur në të gjitha nivelet qeveritare. Zyra e Auditorit Gjeneral nxjerr në pah shkelje të ndryshme të cilat bëhen nëpër tenderët publik, ku kompani të caktuara favorizohen, bëhen pagesa jashtë rregullave të kontratës, punë të kontraktuara mbeten pa u përfunduar, dhe se ndëshkimet për këto dështime pothuajse nuk ekzistojnë.<sup>65</sup> Në vazhdimësi, zyrtarët publik ndërtojnë pasuri e cila nuk përputhet me të ardhurat ligjore.<sup>66</sup> E gjithë kjo bën që përfitimet materiale të sillen në një rreth vicioz në të cilin përfshihen politikanë e biznesmen.

Përkundër ndërlidhjes së ngushtë të politikës me biznesin, prokurorët nuk kanë zhvilluar hetime të cilat do të vinin dritë mbi financimin përmes kanaleve jo ligjore të partive.<sup>67</sup> Manipulimi i shkallës së lartë të zgjedhjeve është rezultat i interesave pikësëpari për përfitime financiare për individë të caktuar. Për këtë, bizneset e caktuara nuk kursejnë mbështetjen financiare dhe janë të gatshme të përkrahin bashkëpunimin kriminal rreth zgjedhjeve. Financimi i dyshimtë i partive apo kandidatëve në njërin anë dhe shpagimi me tender në anën tjetër janë pika kyçe të cilën prokurorët kanë dështuar ta zbardhin manipulimin e zgjedhje.

---

<sup>61</sup> *Deklaratat financiare dhe raporti i auditorit të pavarur (31 dhjetor 2010)* (Prishtinë: Audit & Conto, shtator 2011).

<sup>62</sup> *Monitorimi i kostos së fushatës parazgjedhore: Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010. Transparenca në financimin e subjekteve politike* (Prishtinë: Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), mars 2011).

<sup>63</sup> Bashkim Shehu, "Shoqëria Civile në Kosovë u bën thirrje partive të publikojnë burimet e financave". *Deutsche Welle*, 25 nëntor 2010. Shih [http://www.dw.de/dw/article/0,,6265180\\_page\\_0,00.html](http://www.dw.de/dw/article/0,,6265180_page_0,00.html) (qasur për herë të fundit me 15 maj 2012).

<sup>64</sup> Shih po ashtu, deputeti nga radhët e AAK-së në Kuvend z. Burim Ramadani thekson "... problemi kryesor është me paratë ose mjetet financiare që marrin partitë politike pa u shënuar askund, pra donacionet nga personat fizik dhe juridik, të cilët kthehen në avantazhe ekonomike më pas dhe ky është një veprim korruptiv i drejtpërdrejt. Pra, ky është problemi dhe për këtë ne besojmë se duhet të ngriten mekanizmat kontrollues, sidomos gjatë fushatave, në të cilat kemi edhe fenomenin e blerjes së votave, poashtu edhe fenomenin e korruptimit të sistemit zgjedhor". Prononcim në emisionin "Target", tema: Financimet e partive në Kosovë. Albanian Screen Television, 30 mars 2012.

<sup>65</sup> Adem Gashi et al., *Arkat Publike: Drejt menaxhimit efikas dhe transparent të buxheteve komunale* (Prishtinë: KIPRED, mars 2011).

<sup>66</sup> *Raporti i Progresit 2011* (Bruksel: Komisioni Evropian, 12 tetor 2011), f. 13.

<sup>67</sup> IKD intervistë me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, prill-maj 2012.

## **Lista e votuesve**

Dukuria e votimit të personave të vdekur do të ishte eliminuar sikurse organet qeveritare të kishin freskuar listën e votuesve. KQZ në bashkëpunim me MPB-në kanë formuar një grup punues i cili është duke u marrë me pastrimin e listës së votuesve. Angazhimi rishtas i KQZ-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (në vazhdim, MPB) ka nxjerrë në pah se lista e votuesve përmbante 15,000 persona të vdekur dhe 10,000 persona tjerë të cilët kishin hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.<sup>68</sup> Ndërsa, për 60,000 persona të tjerë është bërë përmirësimi i adresave.<sup>69</sup> Në problemin e listës së votuesve kanë kontribuar mos përgjegjësia e qytetarëve për të lajmëruar vdekjet si dhe mungesa e koordinimit brenda MPB-së për të pastruar hequr nga lista vdekjet e lajmëruara dhe ato të heqjes dorë nga shtetësia.<sup>70</sup> Ky numër i votuesve potencialisht ka mundur të keqpërdoret nga komisionerët në ditën e votimit.<sup>71</sup>

IKD vlerëson se pastrimi i listës së votuesve paraqet sfidë në mënyrë që të eliminohen mundësitë për keqpërdorim në ditën e votimit. Andaj, përgjegjësia për dështimin e pastrimit të listave të cilat potencialisht kanë mundësuar manipulimin në ditën e zgjedhjeve pikësëpari bie mbi MPB-në.

## **Llambat ultravjollce dhe ngjyra e padukshme**

Segment tjetër ku prokurorët nuk kanë marrë mund të hetojnë është dështimi i llambave ultravjollce dhe ngjyrës së padukshme në një numër të madh të vendvotimeve.<sup>72</sup> Madje, ky problem ka bërë që një komunë e tërë të shkoj në rivotim.<sup>73</sup> Pasi që problemi është shfaqur gjithandej Kosovës dhe ka krijuar pasoja të ndryshme, përfshi këtu dëmtim të konsiderueshëm të buxhetit të KQZ-së, bën që ky fenomen të kalojë suazat e një rasti të izoluar. Deri më tani mbetet e paqartë se kush ishte përgjegjës për këtë dështim, komisionerët të cilët tentuan të manipulojnë sistemin apo zyrtarët e Sekretariatit të KQZ-së të cilët ishin përgjegjës për sigurimin e këtij materiali. IKD vlerëson se prokurorët kanë mungesë të njohurive të duhura për proceset e ndryshme të cilat kanë ndikuar në manipulim të votave. Andaj, dështimi i prokurorëve publike për të hetuar dështimin e llambave ultravjollce dhe ngjyrës së padukshme në ditën e votimeve dëshmon mungesën e vullnetit për të zbardhur të gjitha veprimtaritë kriminale që kanë përshkuar këto zgjedhje.

---

<sup>68</sup> "15 mijë persona të vdekur në listat e votuesve". RTV 21, 31 janar 2012. Shih <http://rtv21.tv/home/?p=56484> (qasur për herë të fundit më 20 maj 2012).

<sup>69</sup> IKD intervistë me z. Florian Dushi, anëtarë i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, qershor 2012.

<sup>70</sup> Po aty.

<sup>71</sup> Po aty.

<sup>72</sup> IKD intervistë me znj. Laura Pula, Prokurore në Prokurori të Shtetit dhe Koordinatore e lëndëve të zgjedhjeve, maj 2012. Po ashtu, IKD intervistë me znj. Valdete Daka, Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, maj 2012.

<sup>73</sup> Komuna e Mitrovicës pas ankesës së Lëvizjes Vetëvendosje për dështimin e llambave ultravjollce dhe vendimit të Gjykatës Supreme, i pasuar me vendimin e KQZ-së ka shkuar në rivotim.

Vetëm me një qasje të gjithanshme të hetimeve, prokurorët do të arrijnë të sjellin përpara drejtësisë organizatorët dhe kryesit në këtë rast.

## 5. POLITIKA E DËNIMEVE

Gjykata Supreme shpalli lëndët e zgjedhjeve si lëndë me prioritet pas dështimeve të gjyqësorit për t'u marrë me lëndët e manipulimit të zgjedhjeve në të kaluarën, shkallës së lartë të manipulimeve të zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2010, si dhe shqetësimeve të ngritura nga diplomatët ndërkombëtarë. Qëndrimi i Kryetarit të Gjykatës Supreme për shpalljen e prioritetit të këtyre lëndëve ka përbërur për herë të parë seriozisht gjykatësit komunal me manipuluesit e zgjedhjeve. Trendi i ngritjes së aktakuzave nga ana e prokurorëve ka sfiduar gjykatësit të cilët për dallim nga prokurorët nuk kanë mundur t'i përgjigjen në mënyrë adekuate konfirmimit dhe zgjidhjes së lëndëve. Deri më tani, prokurorët kanë ngritur akuza për 221 raste ku përfshihen 1,516 persona, ku nga ky numër Gjykatat Komunale kanë konfirmuar 94 raste.<sup>74</sup> Paralajmërimet e Prokurorit të Shtetit për ngritje të akuzave ndaj 758 personave të tjerë mund të paraqesin një alarm për gjyqësorin, i cili nuk ka arritur të ndjekë dinamikën e prokurorive.

Sipas të dhënave të Gjykatave Komunale të Kosovës, deri më tani në punë janë 154 lëndë, ku janë zgjidhur vetëm 41 sosh ku përfshihen 191 persona. Ka disa faktorë të cilët kanë ndikuar që shkalla e zgjidhjes së lëndëve të jetë kaq e ulët për momentin. Në disa gjykata ku ende nuk ka lëndë të zgjidhura janë caktuar seancat për shqyrtimin e këtyre rasteve.<sup>75</sup> Mungesa e prokurorëve dhe gjykatësve në sistemin e drejtësisë në Kosovë ka ndikuar gjithashtu në zgjidhjen e lëndëve të zgjedhjeve, sikurse që është rasti i Gjykatave Komunale në Viti dhe Kamenicë.<sup>76</sup> Në disa raste tjera, problem paraqesin palët e rastit, ku mungesa e tyre shkakton zvarritje të zgjidhjes së lëndëve.<sup>77</sup> Figura më poshtë paraqet efikasitetin e Gjykatave Komunale për të zgjidhur lëndët e zgjedhjeve.

---


<sup>74</sup> Këto janë të dhëna të Prokurorit të Shtetit, të cilat janë vetëm për rastet e zgjedhjeve të përgjithshme 2010. Në anën tjetër, Gjykatat kanë të dhënat të cilat përfshijnë edhe rastet e zgjedhjeve para atyre të vitit 2010, të cilat flasin për 154 lëndë në punë.

<sup>75</sup> IKD intervista me z. Bashkim Hyseni, Kryetari i Gjykatës Komunale në Ferizaj, dhe znj. Afijete Sada, Kryetare e Gjykatës Komunale në Gjakovë, qershor 2012.

<sup>76</sup> IKD intervista me z. Skënder Shefkiu, U.D. i Kryetarit të Gjykatës Komunale në Viti, dhe z. Jashar Gashi, Kryetar i Gjykatës Komunale në Klinë, qershor 2012.

<sup>77</sup> IKD intervistë me z. Ramiz Azizi, Kryetar i Gjykatës Komunale në Gjiilan, qershor 2012.

**FIGURA 2**  
**Lëndët e zgjedhjeve nëpër gjykata komunale**



**Burimi: Sekretariati i KQZ-së, 31 dhjetor 2011**

Gjykatësit e Gjykatave Komunale në rastet e zgjidhura kanë zbatuar një politikë jo meritore duke pasur parasysh dëmet që i kanë shkaktuar këto krime shoqërisë, buxhetit dhe imazhit të Kosovës. Pjesa dërmuese e dënimeve apo 68.8% kanë qenë dënime me gjobë dhe kusht, ndërsa vetëm 9.4% e tyre janë dënime me burgim efektiv. Dënimet me gjobë prej 300 deri në 1,350 Euro, vlerësohen të jenë tejet të ulëta për të arritur qëllimin e dënimit, qoftë ndëshkimin e personave të përfshirë apo parandalimin për të ardhmen.<sup>78</sup> Tabela më poshtë paraqet politikën e dënimeve për të gjitha rastet e zgjidhura deri në fund të vitit 2011 nga Gjykatat Komunale.

<sup>78</sup> IKD intervistë me z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, prill-maj 2012.

**TABELA 4**  
**Politika e dënimeve nga Gjykatat Komunale**

| Gjykata Komunale* | Persona në lëndë të zgjidhura | Burg        | Gjobë        | Kusht        | Refuzuar    | Lirues      | Mënyrë tjetër |
|-------------------|-------------------------------|-------------|--------------|--------------|-------------|-------------|---------------|
| Gjilan            | 2                             | 1           |              |              |             | 1           |               |
| Kamenicë          | 6                             | 6           |              |              |             |             |               |
| Deçan             | 7                             |             |              |              |             |             | 7             |
| Gjakovë           | 1                             | 1           |              |              |             |             |               |
| Prishtinë         | 2                             |             |              | 1            |             |             | 1             |
| Ferizaj           | 19                            | 1           | 3            | 7            | 4           | 3           | 1             |
| Shtërpce          | 8                             | 1           |              | 4            |             | 3           |               |
| Drenas            | 138                           | 4           | 85           | 27           | 1           | 4           | 17            |
| Kaçanik           | 3                             | 3           |              |              |             |             |               |
| Lipjan            | 1                             |             | 1            |              |             |             |               |
| Mitrovicë         | 2                             |             | 2            |              |             |             |               |
| Skënderaj         | 1                             |             | 1            |              |             |             |               |
| Vushtrri          | 1                             | 1           |              |              |             |             |               |
| <b>TOTAL:</b>     | <b>191</b>                    | <b>18</b>   | <b>92</b>    | <b>39</b>    | <b>5</b>    | <b>11</b>   | <b>26</b>     |
| <b>%</b>          | <b>100%</b>                   | <b>9.4%</b> | <b>48.2%</b> | <b>20.4%</b> | <b>2.6%</b> | <b>5.8%</b> | <b>13.6%</b>  |

**Burimi: Sekretariati i KQZ-së, 31 dhjetor 2011**

Arsyet për vendimet e tilla të gjykatësve në Gjykatat Komunale mbesin të paqarta por faktorë kyç mbetet edhe presioni i partive politike.<sup>79</sup> Duke parë këtë politikë të dënimeve, prokurorët kanë ushtruar ankesa ndaj të gjitha aktgjykimeve ku dënimet nuk kanë qenë me burgim efektiv, duke bërë kështu që me raste të zgjedhjeve të ballafaqohen edhe Gjykatat e Qarkut.<sup>80</sup> Se dënimet e Gjykatave Komunale nuk ishin meritore vërtetohet nga ashpërsimi që është bërë në Gjykata të Qarkut. Këto gjykata kanë ndjekur një politikë më të ashpër të dënimit duke konvertuar të gjitha dënimet paraprake në dënime me burgim efektiv, kryesisht nga gjashtë muaj burgim për secilin të akuzuar.<sup>81</sup> Politika e tillë e dënimeve ka dhënë shembull për Gjykatat Komunale se si duhet llogaritur dëmin e shkaktuar nga zgjedhjet, krejt kjo në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit. Njëkohësisht, publiciteti i dhënë këtyre dënimeve është duke zbrapsur komisionerët nga përfshirja në manipulime në të ardhmen, sikurse që është vërtetuar në zgjedhjet për kryetar komune në Ferizaj në vitin 2012. IKD konsideron se politika e tillë e dënimeve duhet ndjekur nga të gjitha gjykatat.

Përkundër dëmtimit të buxhetit të Kosovës për shkak të manipulimeve që kishin për pasojë rivotimin dhe rinumërimin, deri më tani nuk kemi kompensim të këtij buxheti nga personat

<sup>79</sup> IKD intervistë me gjykatës që është marrë me lëndë të zgjedhjeve, maj 2012.

\* Për shkak të mungesës së lëndëve të zgjidhura, IKD ka hequr nga tabela këto gjykata komunale të këtyre komunave: Viti, Prizren, Dragash, Malishevë, Rahovec, Suharekë, Pejë, Istog, Klinë, Podujevë, Leposavic, dhe Zubin Potok.

<sup>80</sup> IKD intervistë me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, prill-maj 2012.

<sup>81</sup> IKD ka siguruar aktgjykimet e gjykatave të qarkut përmes Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, maj 2012.



që e dëmtuan atë. Në proceset gjyqësore të deritanishme ku janë dënuar manipuluesit e zgjedhjeve, gjykatat e kanë cilësuar si palë të dëmtuar KQZ-në.<sup>82</sup> Tutje, gjykatat kanë udhëzuar përfaqësuesit e KQZ-së që të procedojnë në procedurë civile për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike. Deri më tani, KQZ nuk ka synuar që t'i kompensoj dëmet,<sup>83</sup> duke bërë kështu që drejtësia të mos vihet në vend. Pavarësisht dënimeve për vepra penale të cilat u shqiptohen komisionerëve dhe personave tjerë, është obligim i KQZ-së që të shfrytëzoj paranë publike në mënyrë efikase dhe të kërkojë kompensim për dëmet që individë të caktuar i kanë shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës.

---

<sup>82</sup> *Aktgjykim ndaj tetë të akuzuarve për veprën penale mashtrim në votime, neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Aktgjykimi numër P.nr.163/2011, Gjykata Komunale në Glogoc, 27 maj 2011. Po ashtu, aktgjykim ndaj gjashtë të akuzuarve për veprën penale mashtrim në votime, neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së. Aktgjykimi numër AP.nr.41/2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, 7 maj 2012.*

<sup>83</sup> IKD intervistë me znj. Valdete Daka, Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, maj 2012.

## 6. KOSTO PËR SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS

Pasi që në 712 vendvotime janë gjetur prova të pakontestueshme të cilat dëshmojnë manipulimin e votave, para organeve të drejtësisë do të paraqiten rreth 5,000 komisionerë. Në bazë të trendit të tanishëm të politikës së dënimeve nga Gjykatat e Qarkut, rezulton se të gjithë të dënuarit për manipulim në zgjedhje të dënuar nga shkalla e parë me gjobë, janë konvertuar në dënime me burg efektiv prej gjashtë muajve. Në qoftë se marrim si mesatare dënimin me burg efektiv prej 3 muaj për secilin të dënuar, për 5,000 persona në fjalë do të kemi 15,000 muaj apo 450,000 ditë burgim efektiv. Përfundimisht, buxhetit të Republikës së Kosovës të gjithë këta të dënuar për t'i mbajtur të izoluar në vuajtje të dënimit, do t'i kushton 12.6 milionë Euro, duke pasur parasysh se për një natë një i burgosur i kushton buxhetit të Kosovës rreth 28 Euro.

**TABELA 5**

**Implikimet e mundshme buxhetore për Shërbimin Korrektues të Kosovës**

| Manipulues të mundshëm | Dënimi me burg efektiv për manipulues (muaj) | Total burgim efektiv (muaj) | Total burgim efektiv (ditë) | Kosto për një natë për të burgosur (Euro) | Kosto totale për manipuluesit e burgosur |
|------------------------|----------------------------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-------------------------------------------|------------------------------------------|
| 5,000                  | 3                                            | 15,000                      | 450,000                     | 28.00                                     | 12,600,000                               |

**Burimi: Kalkulim i IKD-së bazuar në të dhëna të prokurorive, gjykatave dhe Ministrisë së Drejtësisë**

## 7. PËRFUNDIMET

Përgjegjës për manipulimin e zgjedhjeve janë përfaqësuesit e partive politike, të cilët ishin ekzekutues të këtyre krimeve. Shfaqësimi i partive politike dhe të tjerëve se defektet e sistemit zgjedhor në Kosovë janë shkaktar i manipulimeve në zgjedhje nuk qëndron aspak për shkak se këto krime janë si pasojë e faktorit njeri. Mungesa e përgjigjes së organeve të drejtësisë në të kaluarën ndaj rasteve të keqpërdorimeve të votave ka bërë që në vazhdimësi ato të masivizohen. IKD vlerëson gatishmërinë e Gjykatës Supreme dhe të Prokurorit të Shtetit për të shpallur për herë të parë në dhjetor 2010 lëndët e zgjedhjeve me prioritet.

IKD konsideron se format nga më të ndryshme të manipulimit të zgjedhjeve janë të dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Përkundër shkallës së manipulimit të lartë të votave dhe përfshirjes të një numri enorm të komisionerëve, Prokurori i Shtetit nuk ka bërë fare përpjekje që të gjejë organizatorët e këtyre krimeve, njëherësh shkaktarët kryesor. Prokurorët janë mjaftuar me akuzimin e ekzekutuesve të këtyre krimeve duke zhvilluar hetime të kufizuara të cilat amnistojnë tutorët. Përkundër sukseseve të deritanishme, me ngritjen e akuzave ndaj 1,516 personave, prokurorët ende nuk kanë arritur që të zhvillojnë hetime të gjithanshme për të gjetur organizatorët e këtyre manipulimeve, dështimet e llambave ultravjollce dhe ngjyrës së padukshme, financimin e dyshimtë të partive politike si dhe listat e pasakta të votuesve.

Gjykatësit komunal kanë dështuar të vlerësojnë në mënyrë të drejtë dhe meritore dëmin e shkaktuar nga manipuluesit e votave, dënimet ndaj të cilëve janë zbatuar sikurse të ishin kundërvajtje. Gjykatat e Qarkut kanë dhënë shenja të vetëdijesimit për krimet e zgjedhjeve duke i shndërruar dënimet jo adekuate të Gjykatave Komunale në dënime me burgim efektiv.

Kjo është hera e parë që organet e drejtësisë janë duke bërë reagim më adekuat për ndjekje dhe gjykim të krimeve të zgjedhjeve. Megjithatë, qasja e tillë assesi nuk mund të jetë e suksesshme për të vendosur drejtësi dhe parandalim të mirëfilltë pa ndjekjen dhe dënimin e organizatorëve të manipulimeve.

## 8. REKOMANDIMET

Në mënyrë që organet e drejtësisë të kenë përgjigje adekuate ndaj krimeve të zgjedhjeve, IKD rekomandon:

1. **Prokuroritë Publike dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës** duhet të shtrijnë hetimet edhe në drejtim të krimit të organizuar, ashtu që të gjejnë organizatorët e krimeve të zgjedhjeve. **Prokurori i Shtetit** të autorizojë Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës të ndjekë elementet e krimit të organizuar në disa drejtime: manipulimi i votave të kandidatëve, financimi i dyshimtë i partive politike, dështimi i llambave ultravjollce dhe ngjyrës së padukshme, si dhe listat e pasakta të votuesve.
2. **Gjykatësit dhe prokurorët** nuk duhet të kufizohen në interpretime por duhet të marrin parasysh interpretimin e gjerë të “dobisë tjetër pasurore a financiare”, sikurse që sugjerojnë dokumentet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
3. **Prokurori i Shtetit** duhet të konsultohet ngushtë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe hisedarë tjerë të përfshirë në procese zgjedhore, ashtu që të ngritë njohuritë e prokurorëve rreth të gjitha formave të manipulimit të zgjedhjeve. Kjo duhet të shërbejë për ndjekjen e keqpërdorimeve që kanë ndodhur si dhe të zhvillojë strategji për parandalimin e manipulimit në të ardhmen.
4. **Gjykatësit e Gjykatave Komunale** dhe të **Qarkut**, duhet të vlerësojnë dëmet e shkaktuara nga krimet e zgjedhjeve dhe dënimet t’i shqiptojnë në mënyrë meritore për të arritur qëllimin e dënimit.
5. **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** si palë e dëmtuar nga manipulimi i zgjedhjeve duhet të kërkojë kompensimin nga personat e dënuar për keqpërdorim, të cilët rrjedhimisht kanë dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo duhet të kërkohet përmes procedurës civile për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike, sikurse edhe sugjerohet nga gjykatësit e lëndëve të zgjedhjeve.
6. **Ministria e Drejtësisë**, përmes **Shërbimit Korrektues të Kosovës**, duhet të krijojë strategji për pritjen e një numri të madh të personave të dënuar të cilët duhet të vuajnë dënimet me burgim efektiv në hapësirat e Shërbimit Korrektues. Deri më tani prokurorët kanë akuzuar 1,516 persona, ndërsa dënimet e Gjykatave të Qarkut pothuajse të gjitha janë me burgim efektiv. Kapacitetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës tash për tash nuk mundësojnë pranimin e një fluksi të dënuarish të cilët janë në procedura gjyqësore. IKD rekomandon shtimin e hapësirave, masave të sigurisë, stafit të Shërbimit Korrektues, si dhe ndarjen e një buxheti adekuat për realizimin e drejtë dhe efikas të ekzekutimit të sanksioneve penale bazuar në ligjin përkatës.

